

## EKSTRAKT NGA INTERVISTA

*[Intervista e gjatë e historisë gojore me narratoren u realizua më 16 maj, 2021 në Prishtinë. Me kërkesen e narratores për anonimitet, ne kemi fshehur identitetin.]*

**Narrarotja:** Në klasën e dymdhetë, se i kom pasë tremdhetë vjet në gjimnaz, jom konë në gjimnaz të përgjithshëm, në klasën e dymdhetë ja pata nisë edhe me punu.

**Intervistuesja:** Ku punojshe?

**Narratorja:** Kom punu shitëse në “Grand Store”. E pajsha nashta, nana jem qat kohë që thashë te “Amortizatorët” nuk merrke rrogën aq sa duhet. Edhe babgjyshi e ka pasë penzinë shumë të ultë, nuk e di sa e kanë pasë në atë kohë 40 euro, a 30, nuk e di. Babi ka punu privat që të kallxova në qebaptore po nuk, rrogën herë ja vanojke ni mujë, herë dy mujë. Domethonë, kurrë nuk e ka pasë ni datë të caktume me thonë e ka rrogën qetash edhe e merr. Gjithmonë e ka marrë në mënyrë të çrregullt, kurrë nuk e kena ditë veç kur ja ka dhonën. Edhe e kom pa që nuk osht’, e pajsha që nuk p’i dalin nonës tem edhe pse kurrë s’ka thonë “s’po më dalin” ose “s’kom”, amo jonë do sene që shihen kaniherë.

Edhe kom pasë qef i kom thonë, “Po du me shku me punu”. Ma ka bo, “Kryje niherë shkollën, tani puno”, i kom thonë, “Kom me kry shkollën edhe kom me punu”. Edhe ja kom nisë edhe kom punu edhe jom shku në shkollë. Domethonë, kom shku në shkollë prej tetëve më ka fillu mësimi deri në ora 13:00, në ora 13:00 jom lëshu p’i shkollës, në gjysë dy jom nisë për punë edhe prej ora 14:00 deri në 10:00 natës kom punu. Edhe u konë periudhë shumë e lodhshme, shumë. Ka ndodhë kaniherë kur jom shku te shpia jom ulë nashta me hongër bukë edhe dej ma ka qitë nona bukën më ka nxonë gjumi, ulun në kauq. Ma bojke, “Çu, a po han bukë?” Ja bojsha, “Jo s’po du bukë”. Veç bijsha flejsha, se nuk mujsha se u lodhsha.

Tani kur i kisha edhe me mësu edhe pse kom punu apet kurrë mësimin nuk e kom lëshu. Gjithmonë jom konë me nota të mira, gjithmonë e kom gjetë kohën me mësu që kur kisha m’u pyt ose diçka bo vaki u çojsha e lejsha orën në 5:00 ora, u çojsha prej 5:00 dej në 7:00 msojsha. Tani ja nissha m’u bo gati a dinë për në ora 08:00, domethonë për me konë në shkollë. Nuk e kom pasë shkollën shumë larg, diku dhetë minuta në komë me ecë, jom shku. Domethonë, qajo kohë u konë shumë e lodhtë edhe qaq

shumë më pat ra imuniteti i trupit edhe lodhja edhe m'u ka pasë formu psorijaza, smuja e lëkurës. Mjeku më ka thonë edhe prej stresit, prej ngarkesës, prej lodhjes në moment që të bjen të shfaqet prej moshës 18, prej moshës 18 deri në moshën 25 vjeçare.

Edhe une jom konë bash në qat moshën që u lodhsha shumë edhe 17 vjet, 16-17 edhe m'u formu psorijaza. Në fillim nuk e disha as çka osht', veç e pajsha që po skuqet lëkura. Tani nana jem, "Me shku te mjeku, me shku te mjeku", thojsha, "Kur ta kom ni ditë pushim" a din, se isha edhe në punë edhe u lodhsha diqysh menxi s'pritsha ni ditë me pasë pushim, thojsha apet m'u çu me nga nëpër mjekë. E pata lonë, e pata gjetë kohën, tani ja pata nisë me përdorë krema e sene, se më thanë, "Nuk heket, kjo veç mirëmbahet". Amo, qajo kohë u konë tepër e lodhshme, sidomos dy vjet se në klasën e dymdhetë edhe tremdhetë më ka ra edhe me punu edhe me shku, me shku në shkollë. Fakulltetin...

**Intervistuesja:** Kallxoma, spjegoma pak...

**Narratorja:** Po?

**Intervistuesja:** Puna çka ka qenë?

**Narratorja:** Puna, puna, kom punu shitëse, më ka ra me nejt, e kena pasë prej 8:00 dej në ora 22:00, sa orë, prej 14:00 dej në ora 22:00, p'i bjen diku tetë orë, a po? Tetë orë në komë jena konë, nuk kena pasë drejt m'u ulë asni moment edhe e kena pasë obligim me pasë, me mathë shtiklla, a dinë take. Se domethonë nëse je shku me të rrafshata ose me të ulëta nuk të kanë pranë, nuk të kanë lonë me hi as mrena. Domethonë, edhe i marrsha gjithmonë në shkollë me veti këpucat, i shtisha në çantë se tani kur shkoj atje me shku me patike, e atje m'i dathë patiket m'i mathë këto. U konë bajagi zor se për shembull prej 8:00 mëngjes niherë lodhja e shkollës, mandej prapë m'u kthy me nejt tetë orë. U konë shumë, trupi, komët të kanë dhimtë komplet.

Sot kur e menoj thom, nuk e di qysh kom mujt nashta edhe rinia, a din, mosha e re e sene. Sot kur e menoj, thom kurrë s'kisha mujtë as dy orë me nejt ashtu. Nuk kena pasë drejtë me nejt ulë asni minut. Edhe bukë kur kena shku me hongër nashta e kena pasë pauzën, aty e kanë bo edhe bukën, kuzhinën e kanë pasë. Kur jena shku me hongër bukë, domethonë u dashtë me hongër për ngutë, nashta për dhetë minuta me kry krejt drekën. Nëse u ardhë dy herë shefi të ka nxonë qaty të ka bërtit nashta, "Çka po rrinë tanë ditën t'u hongër bukë?" A nashta veç sa ja ke nisë me hongër, a din. U konë presioni shumë i madh, non stop na kanë...

**Intervistuesja:** E pagesa?

**Narratorja:** Pagesa u konë shumë e ulët, shumë e ulët, shumë e ulët, dikun 200 euro t'i kanë dhonë edhe ato nuk jonë që t'i jepshin me rregull, se gjithë t'i kanë vanu pesë ditë, gjashtë, dhetë ditë. Edhe nëse ja u ke lyp, a din, i ke thonë, "Po më duhen për diçka" thojke, "Nuk kom. Prit". A din, gjithmonë

privati në ditë të sodit shumë problem e ka pasë. Qetash nashta pak diçka, po në qat kohën, atëherë u kanë shumë, shumë zor me punu te privati, se domethonë i kanë...

**Intervistuesja:** A ke pasë kontratë?

**Narratorja:** Jo, jo, kontratë s'kena pasë. As s'kena pasë kontratë, domethonë paret i kena marrë kesh, na i kanë dhonë qysh kanë mujt. E ke pasë rrogën, bo vaki herë t'i ka dhonë niqind, herë 50, niherë 20 a din, krejt varet qysh i ka konvenu atina m'i dhonë. Nuk jom kanë veç une, jonë kanë krejt punëtorët qashtu. Ma së problemi, për shembull e kanë pasë studentet që jonë kanë në fakultet, se ato e kanë pasë edhe qeranë e banesës edhe u dashtë me pagu qeranë.

A për shembull, ka ndodhë e kom ni shoqe, i ka thonë, "Nuk ma ka dhonë rrogën hala". [Qiradhësi] i ka thonë, "Gjoj se mu s'po më intereson, se të qes prej këtuhit. Me qet date ki me pagu [qiranë]". Niherë lypke, thojke, "Ami paret se po më vyn" a dinë, thojshin, "Jo, s'kena". Gjithmonë punëtori u kanë fajtor pse p'e lyp paren e vet. Edhe kontratat s'janë ardhë në shprehje hiç, ato as me përmën nuk ka guxu kërkush. Nashta edhe shumica punëtorëve nuk e ka ditë që duhet edhe me ju bo se qaq që s'u apliku kërkun hiç qekjo punë.